



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Nr. 38

Vendi: Restorant “ SELECT” - Prishtinë

**PROCESVERBAL**

I takimit të mbajtur më 10. 06. 2009 në restorantin “ SELECT” në Prishtinë

**Morën pjese:** Ismet Beqiri – kryetar, Radmila Vujoviq, Nerxhivane Dauti, Naim Rustemi, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Vezira Emrush, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

**Mungoi:** Hajredin Hyseni (ishte në udhëtim zyrtar).

Takimin e organizoi OSBE-ja dhe i ofroi ndihmë Komisionit për shqyrtimin e Planit të veprimit - Sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian, nga OSBE- ja, Elita Vokshi dhe nga Zyra e mediave e Kuvendit të Kosovës, Celal Ilas.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinatar dhe Visar Krasniqi.

Ismet Beqiri, pasi e pashëndeti organizatorin e këtij takimi, e njoftoi për

**R e n d i n e d i t ë s**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Takim pune për shqyrtimin e Planit të veprimit - Sfidat e Raportit të progresit,

Komisioni nuk e shqyrtoi pikën e parë dhe vendosi ta shqyrtojë në mbledhjen e radhës.

Komisioni e miratoi rendin e ditës.

## **1 Takim pune për shqyrtimin e Planit të veprimit - Sfidat e Raportit të progresit**

**Ismet Beqiri** - I njoftoi për Planin e veprimit – Sfidat e Raportit të progresit dhe i kërkoi Komisionit të përqendrohet në pikat e Raporti, që se cili ta japë kontributin. Sa i përket kohës së realizimit të tij, nuk mund t'u përmbahemi të gjitha atyre, prandaj disa do të shtyhen për muajt që vijnë. Për pikën 5 të **Planit të veprimit** do të angazhohet Komisioni në përmbushjen e detyrave dhe do të paraqiten raportet vjetore për përputhshmërinë e ligjeve me dokumentet, me të cilat mbrohen liritë dhe të drejtat e njeriut. Për P -10 theksoi se është zgjedhur Avokati i Popullit dhe kërkoi të hiqet.

**Naim Rrustemi** – Vërejti dyfishimin e punëve të përshkruara në P - 16 dhe sugjeroi t'i rekomandohej Qeverisë së Kosovës ta nxjerrë legjislacionin sekondar dhe të mos ketë dyfishim të punës.

**Sanije Alijaj** – Ngriti çështjen e Ligjit për barazi gjinore dhe ishte e mendimit të fillohet me nisëm për plotësimin dhe ndryshimin e tij, nga se ka mbështetje në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ajo ishte kategorike për mos lejimin dyfishimit të punëve të Agjencive. Ndërsa për ta ndryshuar Ligjin për barazi gjinore ishin pro Nerxhivane Dauti dhe Drita Maliqi.

Ishte e mendimit të ushtrohet mbikëqyrje në Qeveri dhe Ministri, për ato rekomandime që i ka miratuar Kuvendi i Kosovës dhe nuk po zbatohen (P. 24, 1) .

**Ibrahim Makolli** – Tha se Komisioni nuk duhet të kërkojë nga institucionet përkatëse sa po zbatohen ato rekomandime, ngase me Rregulloren e punës të Kuvendit, Komisioni e mbikëqyr zbatimin e ligjeve.

Ndërsa lidhur me P. 24 shtoi se kjo çështje është e tejkaluar. Qeveria është e detyruar ta zbatojë Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare. Për P. 24.3 tha se Komisioni ta shqyrtojë Raportin e Avokatit të Popullit dhe të nxjerrë analiza, në mënyrë që të shihen përmirësimet në fushat e caktuara. Ai u angazhua edhe për sigurimin e mjeteve buxhetore për të funksionuar Avokati i Popullit.

**Sanije Alijaj** - U zotua që kjo çështje Komisionit t'i paraqitet me shkrim.

**Vezira Emrush** – Kërkoi të formohet një nënkomision, që për së afërmi të mbikëqyrë zbatimin e të drejtave të njeriut, me theks të veçantë të shikohen komunitetet, por nuk mund të bazohemi në mjetet e informimit dhe në të dhënat që japin organizatat joqeveritare.

**Sanije Alijaj** – Lidhur me P. 43. 3, propozoi të kërkohen mjete financiare të destinuar për strehimoret, në të cilat janë të vendosura gratë dhe fëmijët, në mënyrë që të jenë nën mbikëqyrjen adekuate. Për pikën P. 44 Komisioni angazhohet për organizimin e dëgjimit publik me Ministrinë e Arsimit dhe të Shëndetësisë. U diskutua edhe për pikat P. 45, dhe P. 46. , sipas të cilave Komisioni merr për detyrë ta ftojë për dëgjim publik kryesuesin e Komitetit Ndërministror. Lidhur me pikën P. 49 tha se Ligji për shitjen e banesave i ka kaluar të gjitha procedurat nëpër komisionet funksionale, mirëpo ka mbetur në Komisionin për Komunitete.

U diskutuan edhe pikat: P. 87, 2 , P. 96. 3, P. 102. 3, P. 107. 4, 109 .1.

**Ibrahim Makolli** – Lidhur me pikën 109. 2 theksoi se do ishte mirë ta organizonim një konferencë rajonale bashkë me ndonjë organizatë, sepse aty mund të kërkohet ndërmerren veprime në nivel rajoni. Sa i përket pikës P. 110. 3, Komisioni e ka për detyrë ta mbikëqyrë zbatimin e ligjit. Por lidhur me pikën P. 110. 4, shtoi se këtu duhet të kërkohet përshejtimi i Ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

Komisioni vendosi që në mbledhjen e ardhshme t'i shqyrtojë të gjitha pikat dhe t'i ndajë detyrat që dalin sipas Plani të veprimit - Sfidat e Raportit të progresit.

Takimi përfundoi në orën 13,00

Kryetari i Komisionit

.....

Ismet Beqiri